



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE PROJEKTEVE NË FUSHËN E
DREJTËSISË, INTEGRIMIT DHE NEGOCIATAVE
SEKTORI I POLITIKAVE DHE STRATEGJIVE NË FUSHËN E DREJTËSISË**

**PROCESI I BASHKË-KRIJIMIT, PLANI KOMBËTAR I VEPRIMIT OGP 2026-2030”-
“AKSESI NË DREJTËSI”**

*Prezantimi i gjetjeve të anketës, dakordësia mbi angazhimet dhe vijimi i procesit për hartimin e
OGP 2026–2030 – Komponenti “Aksesi në Drejtësi”-MD*

Takimi i dytë konsultativ¹

Minutat e Takimit

Datë: 17.04.2026

Ora: 10:00 – 12:00

Më datë 17 prill 2026 u zhvillua takimi i radhës në kuadër të procesit të bashkë-krijimit për hartimin e Planit Kombëtar të Veprimit OGP 2026–2030, me fokus komponentin “Aksesi në Drejtësi”.

Takimi u drejtua nga Z. Tedi Dobi, Zëvendës Ministër i Drejtësisë dhe Negociator për Kapitullin 23 (Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore), i cili theksoi rëndësinë strategjike të procesit në kuadër të integritimit evropian dhe forcimit të shtetit të së drejtës. Ai nënvizoi se bashkë-krijimi është një

¹ (Takimi i dytë është zhvilluar më datë 17 prill 2026, ftesa për off-të dhe institucioneve ju është dërguar me email më datë 10 prill 2026, rreth 150 organizatave jofitimprurëse dhe institucioneve, përfshirë edhe institucionet në varësi të Ministrisë së Drejtësisë. Gjithashtu, Agjenda, së bashku me një përshkrim të shkurtër të takimit, si dhe gjetjet me kryesore të pyetesorit është publikuar paraprakisht edhe në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, në funksion të transparencës dhe gjithëpërfshirjes.

instrument kyç për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies dhe për përmbushjen e standardeve të Bashkimit European.

Gjatë fjalës së tij z. Dobi, theksoi gjithashtu rëndësinë e përfshirjes së organizatave të shoqërisë civile (OJF) në të gjitha proceset vendimmarrëse të Ministrisë së Drejtësisë, duke i konsideruar partnerë të rëndësishëm në hartimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave publike. Sipas tij, kjo qasje ka kontribuar në përmirësimin e cilësisë së politikëbërjes dhe forcimin e karakterit gjithëpërfshirës të reformave.

Në vijim u theksua rëndësia e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024–2030, lidhur me këtë komponent, e cila ndër të tjera synon garantimin e aksesit në drejtësi për gratë dhe grupet vulnerabël, rritjen e ndërgjegjësimit ligjor, përmirësimin e komunikimit institucional dhe krijimin e mekanizmeve lehtësues për aksesin në drejtësi. Në këtë kuadër u theksua roli i Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, si dhe nevoja për përmirësimin e kapaciteteve njerëzore dhe infrastrukurore, me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimeve.

Znj. Elona Bano, Drejtore e Përgjithshme, u shpreh se takimi i parë shërbeu për prezantimin dhe nisjen e procesit, ndërsa ky takim fokusohet në prezantimin e të dhënave të nxjerra nga pyetëtori dhe në hapat e mëtejshëm.

Pyetëtori i realizuar kishte karakter të kombinuar, duke përfshirë elemente sasiore dhe cilësore. Pjesa sasiore synoi mbledhjen e të dhënave numerike mbi perceptimet dhe vlerësimet e aktorëve të ndryshëm lidhur me aksesin në drejtësi, ndërsa pjesa cilësore u fokusua në identifikimin e problematikave, barrierave dhe sugjerimeve konkrete për përmirësimin e sistemit të drejtësisë. Ky kombinim metodologjik mundësoi një analizë më të thelluar dhe më gjithëpërfshirëse të situatës.

Znj. Bano, prezantoi gjetjet e anketës me 98 pjesëmarrës nga institucione publike, shoqëri civile, qytetarë, profesionistë të drejtësisë dhe akademikë. Ajo theksoi se rezultatet përputhen me problematikat e identifikuara më herët dhe mbështesin nevojën për vijimin e reformave në aksesin në drejtësi.

Nga analiza e të dhënave rezultoi se në pyetësor kanë marrë pjesë gjithësej 98 të anketuar. Struktura e pjesëmarrjes karakterizohet nga një peshë dominuese e institucioneve publike, të cilat përbëjnë afro 40% të totalit, duke reflektuar një angazhim të lartë institucional në procesin e OGP.

Paralelisht, organizatat e shoqërisë civile zënë një peshë të konsiderueshme, çka dëshmon për një përfshirje aktive të aktorëve jo-shtetërorë në proceset e qeverisjes së hapur. Në të njëjtën kohë, pjesëmarrja e qytetarëve dhe e grupeve të specializuara, si profesionistët e drejtësisë dhe akademikët, paraqitet në nivele më të ulëta, duke treguar nevojën për zgjerimin e mëtejshëm të përfshirjes së këtyre kategorive në proceset konsultuese.

Në kuadër të identifikimit të sfidave kryesore që hasin qytetarët në aksesin në drejtësi, nga analiza e përgjigjeve rezulton se: të dhënat tregojnë se kohëzgjatja e proceseve gjyqësore përbën pengesën kryesore në aksesin në drejtësi, e identifikuar nga pothuajse gjysma e të anketuarve. Ky rezultat reflekton problematikat e vazhdueshme që lidhen me efikasitetin e sistemit gjyqësor dhe ndikimin e drejtpërdrejtë që vonesat procedurale kanë në aksesin real të qytetarëve në drejtësi.

Në një nivel të dytë rëndësie renditet mungesa e informacionit ligjor, e cila evidentohet nga rreth një e pesta e të anketuarve, duke theksuar nevojën për përmirësimin e transparencës dhe aksesit në informacion për publikun e gjerë.

Kostot financiare dhe mungesa e besimit në sistem përfaqësojnë gjithashtu barriera të rëndësishme, duke treguar se aksesin në drejtësi ndikohet jo vetëm nga faktorë proceduralë, por edhe nga faktorë ekonomikë dhe perceptimi publik mbi integritetin dhe funksionimin e sistemit.

Ndërkohë, procedurat e komplikuar dhe mungesa e ndihmës juridike falas identifikohen si pengesa shtesë që ndikojnë veçanërisht në grupet më vulnerabël, duke kufizuar mundësinë e tyre për të ndjekur rrugët ligjore.

Në fund, megjithëse me peshë më të ulët, problematika të tilla si aksesueshmëria për personat me aftësi të kufizuara dhe kategori të tjera të përfshira në përgjigjen “tjetër” tregojnë për nevojën e adresimit të çështjeve specifike që lidhen me përfshirjen dhe barazinë në aksesin në drejtësi.

Lidhur me Fushat prioritare për përmirësimin e punës së Ministrisë së Drejtësisë, nga analiza e përgjigjeve të anketuarve rezulton se fushat kryesore ku kërkohet përmirësim i punës së M. D, lidhen me digjitalizimin dhe përdorimin e teknologjisë, si dhe me rritjen e pjesëmarrjes së publikut në proceset vendimmarrëse. Ndërkohë, aksesin në drejtësi dhe transparenca mbeten elementë thelbësorë, duke treguar se ekzistojnë ende sfida në ofrimin e shërbimeve të aksesueshme dhe në sigurimin e një administrate të hapur dhe të përgjegjshme.

Lidhur me pyeten për Masa prioritare për përmirësimin e aksesit në drejtësi në kuadër të Planit të Veprimtimit OGP 2026–2030, nga analiza e përgjigjeve, rezulton se digjitalizimi dhe bashkëpunimi me shoqërinë civile dhe transparenca përbëjnë një bllok të rëndësishëm prioritetesh.

Lidhur me pyetje për kontributin e OSHC-ve dhe grupeve të interesit në zbatimin e propozimeve, nga analiza e përgjigjeve, rezultatet tregojnë se roli kryesor i OSHC-ve perceptohet në informimin dhe ndërgjegjësimin e publikut (43%), duke i pozicionuar ato si aktorë kyç në rritjen e njohurive ligjore dhe sensibilizimin e qytetarëve, veçanërisht për grupet vulnerabël.

Një rol i rëndësishëm evidentohet gjithashtu në financimin e iniciativave konkrete (27%) dhe në implementimin e drejtpërdrejtë të masave (20%), çka tregon se OSHC-të nuk shihen vetëm si

mbështetëse në aspektin informues, por edhe si aktorë aktivë në zbatimin praktik të projekteve dhe politikave në fushën e drejtësisë.

Ndërkohë, një përqindje më e vogël e të anketuarve (6%) i konsiderojnë OSHC-të kryesisht si kontribuues në fazën e dhënies së ideve dhe propozimeve, duke reflektuar një rol më të kufizuar në politikëbërje krahasuar me rolin operacional.

Këto të dhëna tregojnë se OSHC-të dhe grupet e interesit perceptohen si partnerë me rol shumëdimensional, që shtrihet nga edukimi dhe ndërgjegjësimi, deri te financimi, implementimi dhe kontributi në reformë. Ky pozicionim nënvizon rëndësinë e përfshirjes së tyre të strukturuar në zbatimin e politikave publike, në mënyrë që të sigurohet një qasje më efektive, gjithëpërfshirëse dhe e orientuar drejt nevojave të qytetarëve.

Sfidat kryesore të evidentuara ishin: kohëzgjatja e proceseve gjyqësore, mungesa e informacionit ligjor, kostot financiare, mungesa e besimit në sistem, procedurat e komplikuar dhe aksesueshmëria e kufizuar për kategori të caktuara. Si prioritetet u identifikuan digjitalizimi i shërbimeve të drejtësisë, përdorimi i të dhënave të hapura, rritja e pjesëmarrjes qytetare dhe të OJF-ve, forcimi i transparencës dhe përmirësimi i edukimit ligjor.

Në këtë kontekst si dhe për adresimin e problematikave znj. Bano u shpreh se do të rishikohet ligji nr. 111/2017 për ndihmën juridike të garantuar nga shteti, me synim thjeshtimin e procedurave, shmangien e mbivendosjeve institucionale, zbatimin e barabartë të skemës dhe zgjerimin e mbrojtjes për kategori të veçanta, përfshirë përfituesit e urdhrave të mbrojtjes. U theksua gjithashtu promovimi i ndërmjetësimit si mekanizëm alternativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe lehtësimin e ngarkesës gjyqësore.

Nga znj. Bano u theksua gjithashtu se procesi i hartimit të Planit të Veprimit OGP 2026–2030 do të zhvillohet në disa faza: identifikimi i angazhimeve prioritare (për të cilën u dakordësua gjatë takimit me ojf dhe institucionet, kjo edhe në referim të analizës së pyetësorit), hartimi i draftit fillestar, konsultimi publik, reflektimi i komenteve dhe finalizimi i planit, në përputhje me kriteret e OGP-së për qartësi, matshmëri dhe orientim drejt rezultateve.

Gjatë takimit OJF-të vlerësuan shumë pozitivisht procesin e ndjekur nga Ministria e Drejtësisë, duke e cilësuar atë si një nga proceset më të mira në përputhje me metodologjinë e OGP-së. Ato theksuan transparencën, njoftimin e rregullt të takimeve, komunikimin e qartë, si dhe prezantimin e gjetjeve nga pyetësi për të cilin ishin në një linjë me konstatimet e Ministrisë së Drejtësisë, të cilat po merrën masa për ndërhyrje.